



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Pulsi Publik XIII

Tetor 2017

Përpiluar nga UNDP në Kosovë – Ekipi i Projektit Pulsi Publik

Prishtinë

Tetor 2017

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të pjesëmarrësve të anketës dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e UNDP-së apo USAID-it

Përmbledhje ekzekutive

Kjo është përmbledhja e trembëdhjetë e Pulsit Publik; ajo bazohet në anketën e kryer gjatë fund të shtatorit dhe fillimit të tetorit 2017 dhe ndjek traditën e përmbledhjeve të mëparshme që shqyrtojnë situatën në zhvillim në Kosovë¹ sipas aspekteve kyçe të saj.

Rezultatet e anketës së fundit tregojnë një rritje të kënaqshmërisë me punën e institucioneve të Kosovës; rreth 36% e kosovarëve u deklaruan të kënaqur me institucionet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të kombinuara (krahasuar me 21% në tetor 2016). Teksa niveli i përgjithshëm i kënaqshmërisë me orientimin politik të Kosovës mbetet i ulët, anketimi i tetorit 2017 tregon rritje të moderuar (14% krahasuar me 8% në tetor 2016). Edhe perceptimi i qytetarëve për sigurinë është rritur me rreth 10 pikë përqindjeje.

Në mënyrë të ngjashme, janë rritur edhe treguesit e Pulsit Publik për Demokratizimin (TD) dhe Besueshmërisë Ekonomike (TBE), të cilët përcjellin mendimet e kosovarëve për praktikat demokratike (votimi, liria e shprehjes, etj.) dhe perceptimet për kushtet mbizotëruese ekonomike, por ende mbeten të ulët. Në një shkallë nga 0, rezultati më i ulët, në 3, rezultati më i lartë, TD shënoi 1,37 dhe TBE shënoi 1,22. Përkundër luhatjeve të raportuara në perceptimet e qytetarëve, nivelet e përgjithshme të kënaqshmërisë me performancën e institucioneve kyçe të Kosovës janë mjaft të ulëta. Nëpërmjet Anketës së Pulsit Publik, qytetarëve iu kërkua të identifikojnë problemet kryesore me të cilat po përballet Kosova sot. Ndër të tjera, qytetarët raportuan papunësinë (40% në krahasim me 48% në tetor 2016), korrupsionin (17% në krahasim me 7% në tetor 2016) dhe varfërinë (9% në krahasim me 21% në tetor 2016) si problemet kryesore që ndikojnë në mirëqenien e tyre sociale.

Përveç problemeve më të mëdha të theksuara, 42% e kosovarëve - niveli më i lartë që nga prilli i vitit 2014 - u deklaruan të kënaqur me punën e Kryeministrit. Ndërsa krahasimi i rezultateve aktuale me ato të vitit të kaluar, tregon rritje të kënaqshmërisë së qytetarëve edhe me performancën e Presidentit (38%, krahasuar me 26% në tetor 2016). Ngjashëm, për Kuvendin dhe Kryetarin e

¹ Për UNDP-në, referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

Kuvendit janë parë nivelet më të larta të kënaqshmërisë që nga prilli 2014. Anketa aktuale vëren edhe rritjen më të madhe, që nga prilli i vitit 2014, në nivelin e kënaqshmërisë me punën e gjykatave dhe prokurorisë. Përveç gjetjeve të theksuara më lart, kjo përmbledhje diskuton edhe gjetje të tjera në mënyrë që të ofrojë një pasqyrë të thelluar të situatës aktuale në Kosovë.

Treguesit kryesorë të Pulsit Publik

Kënaqshmëria e perceptuar me performancën e institucioneve të Kosovës

Rezultatet e anketës aktuale të Pulsit Publik tregojnë një rritje të përgjithshme të kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e institucioneve kyçe në Kosovë. Rreth 36% e kosovarëve duket se janë të kënaqur me institucionet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore të kombinuara. Mes tetorit 2016 dhe tetorit 2017, nivelet e kënaqshmërisë me punën e Kryeministrit dhe të institucioneve qendrore u rritën me përkatësisht 22 dhe 12 pikë përqindjeje, duke arritur nivelet më të larta që nga prilli i vitit 2014. Për më tepër, edhe nivelet e kënaqshmërisë me punën e institucioneve legjislative, si Kuvendi dhe Kryetari i Kuvendit, u rritën me rreth 13 dhe 11 pikë përqindjeje. Në mënyrë të ngjashme, edhe kënaqshmëria e qytetarëve me punën e Presidentit është parë të rritet me rreth 12 pikë përqindjeje. Gjyqësori nuk bën përjashtim nga kjo rritje e përgjithshme e kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e institucioneve kyçe të Kosovës, pasi niveli i kënaqshmërisë me punën e gjykatave të Kosovës është rritur me rreth 15 pikë përqindjeje që nga tetori 2016. Edhe niveli i kënaqshmërisë me punën e Prokurorisë u rrit me rreth 17 pikë përqindjeje, duke e çuar në nivel të lartë prej 33%, krahasuar me vetëm 16% në tetor 2016 (Tabela 1).


Tabela 1: Nivelet e kënaqshmërisë me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore të Kosovës

Treguesit politike		Mars-07	Maj-07	Qer-09	Pri-10	Nën-10	Qer-11	Tet-12	Pri-13	Pri-14	Nën-14	Mars-15	Shta-15	Pri-16	Tet-16	Tet-2017	Tendencat
Kënaqshmëria me ekzekutiv	Institucionet qendrore	30.5%	46.9%	53.1%	29.2%	25.1%	32.6%	27.2%	27.0%	44.2%	19.3%	18.1%	17.3%	17.8%	20.2%	32.4%	
	Kryeministri	54.0%	72.0%	53.8%	36.4%	30.7%	37.6%	27.3%	30.4%	48.3%	34.1%	23.6%	14.6%	18.3%	19.7%	42.3%	
Kënaqshmëria me legjislativ	Kuvendi	31.0%	51.4%	53.2%	34.1%	32.1%	41.0%	32.1%	32.3%	46.3%	16.1%	19.3%	19.9%	17.3%	18.9%	31.7%	
	Kryetari i Kuvendit	35.4%	56.3%	51.6%	36.0%	33.3%	60.9%	44.7%	45.8%	57.8%	23.3%	20.1%	19.8%	24.3%	24.9%	36.0%	
Kënaqshmëria me Presidentin	Presidenti	52.0%	74.0%	61.7%	54.9%	30.8%	54.1%	47.1%	45.1%	48.8%	40.7%	30.2%	30.4%	45.7%	25.5%	37.6%	
Kënaqshmëria me gjyqësorin	Gjykata	20.0%	21.0%	32.7%	27.2%	18.5%	26.9%	24.3%	16.7%	37.3%	22.8%	17.2%	13.9%	18.4%	22.1%	36.9%	
	Prokuroria	22.7%	22.7%	31.7%	26.9%	15.1%	20.0%	15.0%	17.7%	38.1%	21.0%	17.0%	12.8%	16.9%	16.3%	33.1%	


Perceptimet për drejtimin politik dhe ekonomik të Kosovës

Teksa një numër i konsiderueshëm i kosovarëve duket se janë të kënaqur me punën e institucioneve kryesore, panorama ndryshon kur pyeten për kënaqshmërinë e tyre me drejtimin politik që ka marrë Kosova. Vetëm rreth 14% e kosovarëve duket se janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin aktual politik të Kosovës, ndërsa pothuajse gjysma e tyre (43%) duket se janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës. Ngjashëm, pothuajse 43% e kosovarëve deklaruan se janë neutralë në lidhje me këtë çështje (Figura 1).


Figura 1: Kënaqshmëria me drejtimin politik të Kosovës



Megjithëse pakënaqësia e qytetarëve me drejtimin politik të Kosovës ka rënë ndjeshëm në krahasim me vitin 2016, gjetjet aktuale tregojnë se 36% e kosovarëve janë ende të gatshëm t'u bashkohen protestave publike për arsye politike. Kur analizohen këto gjetje përgjatë vijave etnike, një përqindje më e lartë e shqiptarëve (38,5%) sesa e serbëve (6%, krahasuar me 39,5% në tetor 2016) janë të gatshëm t'u bashkohen protestave për arsye politike. Vetëm 14% e anëtarëve të grupeve të tjera etnike (krahasuar me 28% në tetor 2016) deklaruan se ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike (Figura 2).

Figura 2: Përqindja e të anketuarve që do të merrnin pjesë në protesta për arsye politike


Për treguesin e sigurisë, të anketuarit u pyetën nëse ndihen të sigurt apo të pasigurt kur dalin në rrugë. Të dhënat nga tetori i vitit 2017 tregojnë një rënie në numrin e qytetarëve që ndihen të pasigurt, pasi vetëm 31% e kosovarëve deklaruan se ndiheshin të pasigurt në mjedisin e jashtëm (krahasuar me 36% në tetor 2016). Një total prej 70% e të anketuarve deklaruan se ndiheshin përgjithësisht të sigurt në mjedisin e jashtëm (në krahasim me 61% në tetor 2016) (Figura 3). Kur këto të dhëna u analizuan sipas gjinisë, nuk u vërejtën dallime të konsiderueshme mes përqindjes së grave dhe burrave që deklaruan se ndihen të sigurt në rrugë (Figura 3).

Figura 3: Perceptimet për sigurinë

Treguesit e demokratizimit dhe besueshmërisë ekonomike

Rezultatet e anketës së tetorit 2017 tregojnë se TD (1,37) ka arritur nivelin më të lartë që nga nëntori 2010, me një rritje prej rreth 0,33. Asnjë dallim i dukshëm nuk është vërejtur në opinionet e burrave dhe grave lidhur me proceset e demokratizimit në Kosovë. Megjithatë, meqë TD shkon nga 0 në 3, nivelet aktuale të TD-së tregojnë se shumica e kosovarëve nuk kanë mendime pozitive në lidhje me proceset demokratike. Treguesi i Besimit Ekonomik (TBE) shkon nga 0 në 3, dhe një TBE prej 0 deri në 1,5 do të thotë se shumica e kosovarëve nuk kanë besim në ekonomi (ata i shohin kushtet ekonomike si të pafavorshme dhe janë më pak optimistë për të ardhmen e ekonomisë), kurse një TBE nga 1,5 dhe lart tregon shumica e kosovarëve kanë besim në ekonomi (ata i shohin kushtet ekonomike si të favorshme dhe janë më optimistë për të ardhmen e ekonomisë). Të dhënat aktuale të anketës së Pulsit publik tregojnë se TBE-ja e përgjithshme e Kosovës qëndron në 1,22 (krahasuar me 0,94 në tetor 2016), duke treguar rritje pozitive që nga viti i kaluar. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që kosovarët kanë një opinion të favorshëm për ekonominë (Figura 4).

*Figura 4: Treguesit e demokratizimit dhe besueshmërisë ekonomike*²



² Konsultoni faqen e fundit të dokumentit për më shumë informacion mbi përlogaritjen e treguesve.

Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në rritjen e TD-së, të dhënat e tetorit 2016 u krahasuan me ato të anketës aktuale. Komponentët e mëposhtëm të TD-së kanë rolin e vet mes atyre që kanë ndikuar në rritjen e përgjithshme: media gëzon lirinë e shprehjes (52% në krahasim me 42% në tetor 2016), pavarësia e sistemit gjyqësor në Kosovë (31% në krahasim me 22% në tetor 2016), si dhe Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet e vlefshme janë demokratike dhe respektojnë të drejtat e njeriut (41% në krahasim me 32% në tetor 2016). Teksa në tetor 2016 vetëm 28% e të anketuarve besonin se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe mbahen në përputhje me standardet ndërkombëtare, 45% e të anketuarve e besonin këtë në tetor 2017³. Komponentët e tjerë që treguan një rritje të konsiderueshme në perceptimet e qytetarëve përfshijnë: besimin e qytetarëve se institucionet qendrore po punojnë sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës (25%) dhe se Kuvendi monitoron punën e institucioneve qendrore (36%) (Tabela 2).

Tabela 2: Analiza e tendencave të komponentëve të Treguesit të Demokratizimit

Po kryesisht dhe Po plotësisht	Nov-10	Jun-11	Nën-11	Pri-12	Tet-12	Pri-13	Pri-14	Nën-14	Mars-15	Shta-15	Pri-16	Tet-16	Tet-17	Tendencat
A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?	31.0%	29.3%	23.1%	17.0%	16.2%	15.0%	36.4%	34.0%	26.2%	23.0%	30.3%	28.0%	44.6%	
A monitoron Kuvendi performancën e institucioneve qendrore?	20.7%	20.7%	19.4%	16.7%	17.7%	17.5%	28.5%	21.5%	21.2%	21.8%	26.6%	30.8%	36.1%	
A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?	13.2%	15.6%	11.3%	12.3%	15.7%	10.6%	24.8%	16.0%	13.6%	17.6%	21.0%	21.6%	31.2%	
A gëzon media në Kosovë lirinë e shprehjes?	29.2%	33.9%	33.3%	34.7%	37.3%	24.6%	45.4%	39.6%	35.5%	46.5%	47.3%	42.3%	52.5%	
A shërben Shoqëria Civile në Kosovë si monitorues i sinqertë i zhvillimeve demokratike në Kosovë?	22.6%	18.9%	20.3%	19.0%	24.4%	18.3%	28.8%	21.3%	19.5%	23.1%	32.1%	30.1%	34.3%	
A funksionon qeverisja juaj lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	27.7%	26.7%	29.0%	25.7%	27.3%	26.1%	32.6%	29.5%	23.3%	27.2%	28.9%	30.4%	34.0%	
A punojnë institucionet qendrore në Kosovë sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?	14.3%	16.1%	14.6%	12.9%	15.3%	16.4%	26.4%	18.2%	11.8%	15.5%	18.9%	17.9%	24.7%	
A janë kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?	32.6%	27.9%	26.5%	25.9%	26.0%	33.0%	35.3%	24.2%	23.5%	19.8%	31.7%	31.8%	41.4%	
Pavarësisht nga politika e përditshme dhe me vështrimin drejt të ardhmes, a pranoi se proceset demokratike në Kosovë janë vendosur dhe po shkojnë në drejtimin e duhur?	25.6%	24.5%	17.9%	18.1%	18.6%	23.0%	33.0%	19.5%	17.3%	15.4%	23.1%	23.8%	29.7%	


³ Sondazhi aktual u zhvillua pas zgjedhjeve qendrore në Kosovë (11 qershor 2017), por para atyre komunale (22 tetor 2017).

Në mënyrë të ngjashme, përgjigjet pohuese të kësaj ankete për komponentin TBE u krahasuan me ato të tetorit 2016. Këtu, vihet re gjithashtu se të gjithë komponentët luajtën rolin e vet në rritjen e përgjithshme. Rezultatet tregojnë se pritshmëritë pozitive afatshkurtra të kosovarëve (gjashtë muaj) në lidhje me të ardhurat totale dhe kushtet e punësimit të familjeve të tyre janë rritur përkatësisht në 22% dhe 19%. Përveç kësaj, edhe vlerësimi i tyre në lidhje me kushtet aktuale të biznesit dhe punësimit u rrit me 18% dhe 19% përkatësisht, krahasuar me tetorin 2016 (Tabela 4).


Tabela 3: Analiza e tendencave të komponentëve të TBE-së

I favorshëm	Nov-10	Jun-11	Nën-11	Pri-12	Tet-12	Pri-13	Pri-14	Nën-14	Mars-15	Shta-15	Pri-16	Tet-16	Tet-17	Tendencat
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj gjashtë muaj nga sot	16.8%	12.1%	8.5%	9.9%	9.6%	7.6%	17.0%	19.7%	15.1%	15.9%	23.4%	18.0%	22.4%	
Cili është vlerësimi juaj i kushteve aktuale të biznesit	10.7%	9.7%	6.0%	7.9%	6.7%	4.8%	11.6%	8.8%	8.1%	8.3%	14.4%	13.1%	17.9%	
Cili është vlerësimi juaj për gjendjen aktuale të punësimit?	4.0%	3.3%	3.8%	3.4%	3.8%	5.1%	9.2%	7.7%	5.0%	6.8%	10.3%	7.7%	17.1%	
Cilat janë pritshmëritë tuaja në lidhje me kushtet e punësimit gjashtë muaj nga sot	14.3%	12.4%	8.0%	7.6%	7.4%	6.4%	13.7%	7.3%	6.0%	8.0%	14.0%	10.7%	18.7%	


Edhe pse rritja në TBE është e dukshme, gjetjet theksojnë se ka më shumë pakënaqësi me drejtimin ekonomik sesa me drejtimin politik të Kosovës: rreth 46% e të anketuarve janë ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin aktual ekonomik të Kosovës, ndërsa vetëm rreth 18% janë të kënaqur. Kur analizohen në baza etnike, të dhënat e anketës tregojnë se përqindja e serbëve të pakënaqur (57%, krahasuar me 63% në tetor 2016) mbetet më e lartë se ajo e shqiptarëve (47%, në krahasim me 69% në tetor 2016) dhe e komuniteteve të tjera (20%, në krahasim me 73% në tetor 2016) (Figura 5).

Figura 5: Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës**Perceptimet për problemet më kryesore me të cilat përballet Kosova aktualisht**


Më shumë se 65% e kosovarëve konsiderojnë se problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet sot Kosova lidhen me kushtet socio-ekonomike. Të anketuarit zgjodhën papunësinë (40% krahasuar me 48% në tetor 2016), korrupsionin (17% krahasuar me 7% në tetor 2016) dhe varfërinë (9% krahasuar me 21% në tetor 2016) si tre problemet kryesore që ndikojnë në mirëqenien e tyre sociale. Gjithashtu, kjo anketë tregoi se rreth 4% e kosovarëve i konsiderojnë krimin e organizuar dhe shërbimet shëndetësore mes shqetësimeve të tjera të ngutshme (Figura 6).

Figura 6: Perceptimet për problemet më kryesore me të cilat përballet Kosova

Meqenëse kosovarët e perceptojnë papunësinë si problemin më të madh, ata u pyetën për mendimet e tyre rreth mundësive të punësimit të bazuar në merita në sektorin publik. Gjetjet tregojnë se shumica e kosovarëve mbeten skeptikë në lidhje me punësimin e bazuar në merita në sektorin publik. Duke qenë se sektori publik është punëdhënësi më i madh në Kosovë, kjo shpjegon pse vetëm 19% e të anketuarve janë optimistë për gjetjen e punësimit në gjashtë muajt e ardhshëm (Tabela 3). Për më tepër, shumica e kosovarëve (79%) besojnë se lidhjet familjare, ryshfetet, aleancat partiake dhe faktorët e tjerë jo meritore janë më të dobishmit për punësim në sektorin publik. Vetëm rreth 22% e të anketuarve besojnë se arsimi, përvoja profesionale dhe aftësimi profesional ndihmojnë në mënyrë efektive për t'u punësuar në sektorin publik (Figura 7).

Figura 7: Perceptimet për meritokracinë në arritjen e punësimit në sektorin publik

Shumica e kosovarëve mbeten skeptikë për punësimin e bazuar në meritë edhe në sektorin privat. Megjithatë, gjetjet tregojnë se perceptimet mbi punësimin e bazuar në meritë në sektorin privat janë pak më të mira; 34% e të anketuarve besojnë se përvoja profesionale, aftësi profesionale dhe arsimit janë të rëndësishëm për t'u punësuar në sektorin privat. Në përgjithësi, perceptimet mbi mundësitë e punësimit të bazuar në meritë mbeten në nivele të ulëta për sektorin privat dhe atë publik (Figura 8).


Figura 8: Perceptimet për meritokracinë në arritjen e punësimit në sektorin publik

Edhe pse korrupsioni vazhdon të mbetet një fenomen shqetësues për shoqërinë kosovare, ka rënë përqindja e përgjithshme e qytetarëve që perceptojnë se korrupsioni në shkallë të lartë është i pranishëm në institucione të ndryshme (20% krahasuar me 36,5% në tetor 2016). Institucionet që kosovarët perceptojnë se kanë nivelin më të lartë të korrupsionit në shkallë të lartë janë: ofruesit e kujdesit shëndetësor 25,5% (krahasuar me 50% në tetor 2016), Kompania Kosovare për Shpërndarje të Energjisë Elektrike (KEDS) 20,5% (krahasuar me 31% në tetor 2016), gjykatat 25% (krahasuar me 49% në tetor 2016), doganat 23% (krahasuar me 45% në tetor 2016), dhe administrata qendrore 31% (krahasuar me 49% në tetor 2016). Megjithëse përgjithësisht përqindjet kanë rënë për disa institucione, Policia e Kosovës (15% në krahasim me 21% në tetor 2016), organizatat ndërkombëtare (10%) dhe bankat (10%) mbeten institucionet që perceptohen se kanë më pak korrupsion në shkallë të lartë (Tabela 4).

Tabela 4: Perceptimet për nivelin e korrupsionit të shkallës së lartë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë


	Nën-10	Qer-11	Nën-11	Pri-12	Tet-12	Pri-13	Pri-14	Nën-14	Mars-15	Shta-15	Pri-16	Tet-16	Tet-17	Tendencat
Shëndetësia (spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare)	47.9%	40.7%	49.8%	43.3%	51.6%	50.4%	40.4%	56.2%	52.6%	51.5%	37.9%	49.7%	25.5%	
KEDS (Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë në Kosovë)	52.4%	47.9%	61.2%	47.8%	53.8%	48.8%	24.4%	39.1%	44.7%	35.6%	31.1%	31.4%	20.5%	
Gjykatat	49.7%	41.6%	55.6%	44.5%	47.5%	56.4%	32.2%	42.1%	42.9%	46.9%	42.3%	49.3%	24.9%	
Doganat	45.1%	42.3%	53.7%	43.2%	49.9%	58.9%	22.5%	33.4%	38.7%	41.3%	32.3%	45.2%	22.7%	
Administrata qendrore	47.5%	41.4%	43.3%	39.5%	35.7%	46.1%	24.0%	37.5%	38.5%	36.0%	36.6%	49.2%	30.7%	
AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit)	52.0%	40.5%	51.9%	49.4%	46.4%	48.7%	24.6%	34.8%	37.1%	38.3%	39.2%	45.7%	24.9%	
Komunat (qeverisja lokale)	32.9%	30.4%	31.9%	30.1%	32.2%	38.9%	20.6%	33.2%	33.8%	28.6%	30.0%	40.2%	25.5%	
Policia e EULEX-it (CIVPOL)	22.9%	26.2%	27.1%	28.3%	28.7%	38.3%	11.1%	16.5%	32.2%	35.2%	28.8%	34.1%	20.9%	
Arsimi (shkollat, Universiteti)	14.4%	13.1%	17.3%	26.2%	23.5%	31.6%	13.0%	24.3%	29.3%	29.0%	17.5%	31.0%	16.3%	
ATK (Administrata Tatimore e Kosovës)		24.9%	36.5%	38.1%	33.6%	42.5%	16.5%	28.0%	28.1%	25.0%	18.2%	32.5%	17.4%	
PTK	34.0%	32.4%	46.6%	41.8%	45.1%	41.4%	15.4%	21.3%	25.9%	25.2%	18.4%	29.6%	17.0%	
Bankat	14.4%	14.9%	22.0%	20.5%	22.8%	37.5%	12.0%	17.0%	24.3%	23.3%	23.1%	24.4%	13.1%	
Organizatat ndërkombëtare	14.7%	12.3%	20.3%	19.3%	20.8%	24.8%	10.8%	16.2%	20.4%	22.9%	16.0%	28.0%	10.8%	
Policia e Kosovës (PK)	15.2%	15.5%	19.5%	19.4%	28.0%	30.3%	11.5%	16.1%	20.4%	19.0%	13.6%	21.1%	14.9%	

Për të kuptuar faktorët ka u kanë dhënë formë perceptimeve të kosovarëve në lidhje me praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë, të anketuarit u pyetën se ku kanë marrë informacion për këtë çështje. Gjetjet tregojnë se gati gjysma e tyre (48%) i kanë krijuar mendimet e tyre përmes mediave të shkruara dhe elektronike, pasuar nga biseda me miqtë dhe të afërmit (32%) dhe përmes burimeve të tjera (7%). Megjithatë, 13% e të anketuarve deklaruan se i kanë krijuar mendimet e tyre në bazë të përvojave personale, kur u janë kërkuar para, dhurata ose favore të tjera për të marrë shërbime të caktuara (Figura 9).


Figura 9: Mbi çka i bazoni vlerësimet tuaja për korrupsionin e shkallës së lartë?**Qëndrimet kundrejt votimit**

Synimet për të votuar janë të rëndësishme për të kuptuar gjendjen e përgjithshme politike të shoqërisë. Për fat të keq, rezultatet e anketës së fundit tregojnë se qëndrimet ndaj votimit në mesin e kosovarëve janë pesimiste, pasi një numër i konsiderueshëm i të anketuarve besojnë se votimi i tyre nuk mund të ndryshojë situatën në Kosovë (38% krahasuar me 52% në tetor 2016) ose nuk dinë nëse votimi i tyre mund të ndryshojë situatën në Kosovë (24%). Vetëm 38% e votuesve potencialë besojnë se votimi i tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë (*Figura 10*).

Figura 10: Perceptimet për mundësinë për të sjellë ndryshime përmes votimit



Gjithashtu, Anketa e Pulsit Publik i pyeti të anketuarit rreth preferencave të tyre për votim. Gjetjet tregojnë se 71% e të anketuarve (në krahasim me vetëm 36% në tetor 2016) do të votojnë për një parti ose koalicion të caktuar politik nëse zgjedhjet qendrore do të zhvilloheshin në të ardhmen e afërt, ndërsa 11% e të anketuarve nuk kishin ndonjë preferencë politike. Për më tepër, ka një përqindje të konsiderueshme të atyre që deklaruan se nuk do të votojnë në rast të zgjedhjeve qendrore (8% krahasuar me 22% në tetor 2016) dhe atyre që nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje (10% në krahasim me 27% në Tetor 2016) (*Figura 11*).

Figura 11: Preferencat e votimit

Metodologjia

Gjetjet e paraqitura në këtë përmbledhje janë bazuar në një anketën me 1,305 qytetarë të Kosovës mbi moshën 18 vjeçare. Në mostër janë përfshirë të dyja gjinitë, meshkuj dhe femra nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke mbuluar zonat rurale dhe ato urbane. Konkretisht, mostra ka përfshirë 895 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 200 pjesëtarë të pakicave jo-serbe të Kosovës (gjegjësisht turq, boshnjakë, goranë, romë, ashkali dhe egjiptianë). Anketa u krye në bazë të mostrimit me probabilitet rastësor në etapa të shumëfishta. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë. Anketa është realizuar gjatë shtatorit dhe fillimit të tetorit 2017. Të dhënat shtesë të marra përmes kësaj ankete do të bëhen të disponueshme përmes Analizave të Pulsit Publik dhe shkresave të Dokumentit të Veprimit.

Shënim për peshimin e totaleve

Anketat e Pulsit Publik marrin mostra më të mëdha të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të ndahen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë kur bëhen përlogaritjet për totalet, ekipi bën peshimin sipas shifrave aktuale të popullatës.

Që nga viti 2002, për peshimin e totaleve për popullatën e Kosovës kemi shfrytëzuar përqindjet vijuese:

- shqiptarë të Kosovës 88%
- serbë të Kosovës 6%
- të tjerë (boshnjakë, turq, goranë, RAE) 6%

Sipas regjistrimit të popullsisë dhe rezultateve zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike aktuale është si vijon:

Përkatësia etnike	Popullata	Përqindja
Shqiptarë të Kosovës	1.616.869	92,93
Serbë të Kosovës	25.532	1,47
Turq të Kosovës	18.738	1,08
Boshnjakë të Kosovës	27.533	1,58
Romë	8.824	0,51

Ashkali	15.436	0,89
Egjiptas	11.524	0,66
Goranë	10.265	0,59
Të tjerë	2.352	0,14
Gjithsej	1.739.825	100,00

Nëse do t'i aplikonim shifrat e mësipërme në anketat tona, peshimi do të ishte si në vijim:

- 93 % shqiptarë të Kosovës
- 2% serbë të Kosovës
- 5% të tjerë në Kosovë

Duke e pasur parasysh që serbët në pjesën veriore të Kosovës nuk kanë marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë, së bashku me vështrimin e përgjithshëm që shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, ne kemi vlerësuar se duhet të shtojmë edhe 40,000 të tjerë për serbët, që arrin totalin prej 61,532. Kjo gjithashtu rrit numrin e përgjithshëm të popullsisë së Kosovës në 1,779,825.

Kur merren në konsideratë këto ndryshime, peshimi në anketat tona është bërë si në vijim:

- 92% shqiptarë të Kosovës
- 4% serbë të Kosovës
- 4% të tjerë në Kosovë (boshnjakë, turq, goranë, RAE) 6%

Përlllogaritja e treguesve

Treguesi i Demokratizimit është një mesatare e përbërë e bazuar në vlerësimin e të anketuarve të nivelit të tyre të pajtimit apo mospajtimit lidhur me zhvillimin e proceseve të mëposhtme në Kosovë:

shkalla e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, monitorimi i Kuvendit, performanca e institucioneve qendrore, pavarësia e sistemit gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, funksionimi i institucioneve qendrore në bazë të prioriteteve të qytetarëve, kushtetutës dhe ligjeve të bazuara në të drejtat e njeriut dhe nëse qeveritë lokale punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. Ky tregues është vlerë e vazhdueshme e cila mund të sillet nga 0 - 3 (maksimumi), ku rezultati prej 0 do të thotë që asnjë nga të anketuarit nuk konsideron që demokratizimi është në rrugën e duhur, ndërkaq rezultati prej 3 do të thotë që të gjithë të anketuarit pajtohen plotësisht se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Treguesi i besueshmërisë ekonomike është një mesatare e përbërë e cila përlllogaritet në bazë të vlerësimit të anketuarve për mbizotërimin e kushteve të favorshme ose të pafavorshme ekonomike në Kosovë Konkretisht, të anketuarit vlerësojnë kushtet në vijim: pritjet në lidhje me gjendjen e përgjithshme të të ardhurave dhe punësimit të familjes së tyre për gjashtë muajt e ardhshëm dhe vlerësimi i kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. Vlerat mund të sillen nga 0 (minimumi) deri në 3 (maksimumi), ku vlerat nga 0-1,5 tregojnë vlerësim jo të favorshëm të gjendjes ekonomike, ndërsa vlerat 1,5-3 tregojnë vlerësim kryesisht të favorshëm.